



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-15-1839

Paditës: H B nga Shtimja të cilën me autorizim e përfaqëson avokati B I nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës: Ndërmarrja Shoqërore „ Magjistrala ” në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rr. „ Driton Hoxha ”, nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me gjyqtari Hasim Sogojeva, më dt. 20. 12.2023 mori këtë :

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar padia/ankesa e paditësit, ndryshohet vendimi i Autoritetit Likuidues PRN 032 - 0061, dt. 31.05. 2013, dhe obligohet e paditura NSH „Magjistrala”, që paditësit H B t’ ia paguaj pagat e pa paguara në shumën 900.00€, kamatën në lartësi 10 % të shumës themelore si dhe për shpenzime të procedurës në shumën 124.00€, sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 03 korrik 2013, pranë DHPGJS është parashtruar padia grupore në të cilën si paditës është edhe H B , kundër të paditurit në lidhje me Vendimin e Autoritetit Likuidues (AL) për NSH „ Magjistrala ” PRN 032- 0061, dt. 31. 05. 2013, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme pjesërisht kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara, në shumën 900.00 €.

Kjo lëndë ka pasur shenjën C- IV – 13- 1216, por që sipas Urdhrit të Gjykatës kjo lëndë grupore është ndarë si lëndë e veçantë dhe ka marrë numrin, C-IV- 15- 1839.

Paditësi në padi, dhe në parashtrësë të plotësimit të padisë, dt. 30 shtator 2015, ka theksuar se paditësi kishte kërkuar pagat e pa paguara për periudhën e vitit 2006, deri në dhjetor të vitit 2007, në shumën 900.00€ , por e cila është refuzuar si e pa pranueshme .

I autorizuari i paditësit ka theksuar se padinë kundër Vendimit të AL PRN 032- 0061, e kishte ushtruar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale .

I autorizuari i paditësit në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ka deklaruar se e paditura me rastin e vendosjes për kërkesën e paditësit nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënie pune te i padituri, dhe kjo e fundit ka pasur për obligim të paguaj të gjitha pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit të NSH –së , ashtu siç premtohet edhe me dokumentin njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës .

I autorizuari i paditësi thekson se Autoriteti i Likuidimit me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, Vendimin e vetë e mbështet në të dhënat e kërkuara nga Banka Ekonomike në Prishtinë, dt. 22.05.2013, si informata për historikun e llogarisë së Paditësit , për periudhën janar 2006 – prill 2007, dhe thuhet nga përgjigja e Bankës, rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk figuron në listën e pagave të NSH -së si një punëtor i saj. Më tej vendimi i AL me rastin e refuzimit të kërkesës është mbështetur në dispozitën e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 .

I autorizuari i paditësi ka theksuar se Banka Ekonomike nuk është institucion që lëshon apo ruan dhe mban listën e pagave, të punëtorëve dhe se pikërisht lista e pagave duke filluar nga janari i vitit 2006 deri në prill të vitit 2007, është si provë që vërteton borxhin dhe lartësinë sepse ajo është lëshuar nga personat kompetent të NSH-së .

I autorizuari i paditësit në lidhje me zbatimin e gabuar të drejtës materiale thekson se Autoriteti i Likuidimit, Vendimin e ka bazuar në dispozitën e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, kur thekson se kërkesa është e pa vlefshme dhe jo e rregullt , por duket se kjo dispozitë më shumë mekanikisht është futur në vendim, kur dihet se kërkesa është ushtruar brenda afatit dhe e provuar me dokumentacionin e lëshuar nga e paditura .

Në lidhje me kamatën është deklaruar, Ligji për AKP-në me nenin 37.3 , e rregullon këtë situatë juridike, ashtu që kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatën në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së vendimit për likuidim me kusht që ajo të mos tejkalon 10 %, e shumës themelore.

Ka kërkuar që Gjykata të miraton si të bazuar padinë, dhe të anulohet vendimi i të paditurës PRN 032- 0061, dhe të obligohet AKP-ja Autoriteti i Likuidimit për NSH ,, Magjistrala ” për pagat e pa paguar të paguaj shumën 900.00€ , si dhe kamatën ligjore .

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Më dt. 18.05.2023, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër C- IV- 15- 1839 , si për paditësin ashtu edhe për të paditurin .

Më dt. 29.05.2023, i autorizuari i paditësit dorëzoi parashtrësën me të cilën është deklaruar për rrethanat faktike dhe juridike të kërkesës së paditësit. Në parashtrësë është deklaruar se e paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënia pune te e paditura deri në ditën kur ju është lëshuar Letër pezullimi . Sipas njoftimit është theksuar se „Shuma e pagave , duke përfshirë të gjitha rrogat e pa paguara të cilat ende ua ka borxh , Punëdhënësi sipas kontratës së punësimit, do ti trajtoj në përputhje me procedurat e likuidimit ” . Më tej ka theksuar se bazuar në listën e pagave, vërtetohet se paditësit ju kanë mbetur borxh nga NSH-ja, pagat e pa paguara dhe kjo dëshmohet me listat e pagave . Këto lista specifikojnë lartësinë pagës . Me këto lista paditësi është i regjistruar, ndërsa në rubrika janë përshkruar detajet e borxhit, që është në shumën 900.00€. Listat janë hartuar dhe nënshkruar nga personat kompetent të NSH –së, dhe janë dorëzuar në AKP, më dt. 16.07.2007 .

Në parashtrësë është deklaruar se kundërshtimi i të paditurit duke u thirr në dispozitën e nenit 37 paragrafi 9.2, të Shtojcës së ligjit, nr. 04/L-034, nuk është sqaruar ky fakt nga Autoriteti i Likuidimit .

Me këtë parashtrësë ka dorëzuar :

- Vendimin e AL PRN 032- 0061, dt. 31.05.2013,
- Njoftimin e lëshuar nga AKM, dt. 22.05.2007,
- Formulari i kërkesë kreditore,
- Kërkesa drejtuar Zyrës Rajonale të AKP-së , për pagimin e pagave,
- Kopja e Librezës së punës,
- Kontrata e punës,
- Vërtetimin për përvojën e punës,
- Listat e pagave për NJP në Shtime , periudhën e muajit Janar të vitit 2006 deri prill të vitit 2007 ,
- Parashtrësë dt. 16.07.2007, e dorëzuar në Zyrën Rajonale në Prishtinë të AKM-së, nga drejtori ,
- Deklaratë nën betim e dhënë nga drejtori Sh P dhe Llogaritari A K , te noteri B Xh,
- Kontrata e punës,
- Dokumenti Referencë , dt. 16.07.2007,
- Dokumenti , Aktvendim dt. 21.06.2007,
- Regjistri i punëtorëve dhe të dhënat e tyre për NJP , „Magjistrala ” në Prishtinë dt.13.04.2007, nr. rendor 174 dhe
- Kopja e padisë bazë .

Më dt. 08.06.2023, AKP- ja përmes përfaqësuesit me parashtrësë ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj pretendimeve në padinë e paditësit , kundër Vendimit PRN 032-0061, me propozim që ankesa të refuzohet si e pa papranueshme dhe ose / të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit .

AKP-ja, në parashtrësë të mbrojtjes ka pohuar faktin se NSH „, Magjistrala ” ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 13.04.2007, ndërsa paditësi ka ushtruar kërkesë për pagat e pa paguara, më dt. 21.06. 2007, në shumën 900.00€ .

Autoritetit i Likuidimit (AL) ka marrë Vendim PRN 032 - 0061, me të cilin e ka refuzuar kërkesën e parashtruesi si të pa bazuar .

AKP-ja , pretendon se Vendimi i AL është i bazuar në faktet dhe bazat ligjore si në vijim :

- i) Neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 , parashikon „, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo interesit të pronësisë ..kërkesa ose pretendimi është i pasafatëshëm nga kufizimet kohore të aplikueshme ” .
- ii) Neni 608 i Ligjit për punë të bashkuar i vitit 1976, parashikon se pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet .

AL ka kryer verifikime në lidhje me kërkesën në përputhje me nenin 18 të Ligjit për AKP dhe më dt. 22.05.2013, ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike mbi historikun e llogarisë së klientit për periudhën janar 2006 deri në dhjetor të vitit 2007. Më dt. 23 maj Banka Ekonomike ka dorëzuar pranë AKP-së, përgjigjen me të cilën rezulton se parashtruesi i

kërkesës nuk figuron në listë të pagave të NSH –së. Gjithashtu edhe nga arkivi i NSH vërtetohet fakti se parashtruesi i kërkesës nuk figuron si një i punësuar pran NSH –së.

Ka bashkangjitur provat :

- Formularin e kërkesë kreditore, për 10 paga nga 90.00€, në shumën 900.00€,
- Dokumentin Identifikues
- Njoftimin e datës 22.05.2007,
- Kërkesa dt. 16.05.2013,
- Vendimin e AL PRN 032- 0061. .

Arsyetimi Ligjor

Padia e paditësit, është e bazuar.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, ka konstatuar jo kontestuese se paditësi ishte punëtorë i të paditurës NSH “ Magjistrala ” në likuidim, sipas provës materiale njoftim të lëshuar nga AKM-ja më dt. 22.05.2007, me të cilin ju është përfunduar punësimi paditësit, sikundër edhe me librezë të punës kur ju është mbyllur librezja e punës më dt. 13.04.2007. Si kontestuese është baza juridike e kërkesës .

Gjykata, me provën e dokumentit njoftimit për pushimin e marrëdhënies së punës, dt. 22 maj 2007, të lëshuar nga AKM –ja, ka vërtetuar faktin se paditësit H B nga Shtimja i ka pushuar marrëdhënia e punës dhe se NSH -ja ka hyrë në procedurën e likuidimit nga data 13 prill 2007, sipas Vendimit të Bordit të AKM-së.

Në njoftim ndër të tjera theksohet se shuma e parave, duke përfshirë të gjitha rrogat e pa paguara , të cilat ende ua ka borxh Punëdhënësi, sipas kontratës suaj të punësimit, do të trajtohen në përputhje me procedurat e likuidimit dhe bashkangjitur e keni formularin e kërkesave të cili ju lusim ta kompletoni dhe ta dorëzoni në Komisionin e Likuidimit.

Me provën e dokumentit në kopje të Listës së pagave për periudhën shtator deri të vitit 2006, deri në qershor të vitit 2007, e nënshkruar nga personat, në cilësinë e llogaritarit dhe në cilësinë e drejtorit, provohet se në këtë listë për NJP në Shtime është i regjistruar edhe paditësi H B në numrin rendor 24, ndërsa në këtë listë janë të përfshirë 26 punëtor . Sipas kësaj liste, paditësit për muajin janar të vitit 2006, deri në muajin gusht të vitit 2007, ky ishte në listë të pagave, por të njëjtit pagat nuk ju janë llogaritur, për çfarë arsye nuk janë llogaritur pagat , paditësi dhe avokati i tij nuk janë deklaruar. Kështu në listën për muajin shtator të vitit 2006, ju është llogaritur paga bruto, në shumën 90.16€, kontributi pensionale 4.5€, rroga e mbetur 85.65€, tatimi 8.5€ dhe ndalesa për sindikatë 1.7€, paga neto 75.37€, kështu janë llogaritur edhe pagat tjera deri në muajin qershor 2007, edhe pse njoftimi për ndërprerje të punësimit është lëshuar më dt. 22.05.2007.

Me provën e formularit të kërkesës kreditore, paditësi kërkesën kreditore e ka dorëzuar te Autoriteti i Likuidimit për pagat e pa paguara në shumën 900.00€, në të cilën kërkesë ka llogaritur për 10 muaj x 90.00€ pagën mujore, shuma e tërësishme 900.00€ , por në formular nuk e ka precizuar periudhën kohore.

Me provën e dokumentit në kopje e pajisur me shenjë ,, Magjistra’’ si njoftim i nënshkruar nga Drejtori, por që nuk është shënuar emri dhe mbiemri i tij , e i dorëzuar në AKM më dt. 16.07.2007, vërtetohet se Drejtori ka dorëzuar regjistrat e punëtorëve të cilët janë të përfshirë

në të ardhurat personale, e që si regjistër përmendet edhe regjistri për NJP në Shtime ku në këtë regjistër është i përfshirë edhe paditësi .

Me provën e deklaratës nën betim të nënshkruar nga Sh P si drejtor i NSH ,, Magjistrala ” dhe A K si llogaritar e cila është dhënë para noterit B Z Xh, LRP 5398/2021, dt. 01.10.2021, sipas të njëjtëve në cilësinë e drejtorit dhe të llogaritarit, të njëjtit kanë hartuar dhe llogaritur dhe nënshkruar listat e pagave për punëtorët deri në ditën e Likuidimit dt. 13.07.2007. Të njëjtit janë deklaruar se kanë qenë persona zyrtar dhe e kemi përfaqësuar ndërmarrjen para Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe i kemi nënshkruar listat e pagave të pa paguara për periudhën e vitit 2005 deri në vitin 2007 të gjitha NJP të Magjistratës , për Drejtorin në Prishtinë, Pejë, Prizren, Shtime, Caralevë, Mitrovicë dhe Gjilan dhe të njëjtat i kemi dorëzuar në AKM, me nr. regjistri 21, dt. 16.07.2007, të cilën shkresë e ka nënshkruar drejtori Sh P .

Me dokumentin kontratë të punës të lidhur në mes Sha Magjistrala dhe Sh P për periudhën prej dt. 01.12.2005 deri më dt. 01.12.2006, të njëjtit ju është vazhduar kontrata e punës në pozitën e drejtorit .

Me dokumentin Referencë e protokolluar nga Magjistrala, me nr. 22, dt. 16.07.2007, të nënshkruar nga A B, vërtetohet se Sh P, me profesion inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, prej dt. 01.01.2006 deri më dt. 13. 04 2007, ka qenë si Kryetar i këshillit drejtues dhe drejtor i përgjithshëm i Magjistrales.

Me regjistrin e punëtorëve të SHA ,,Magjistrala” në Prishtinë, dt. 13.04.2007, ky regjistër përfshin 229 punëtorë , është nënshkruar më dt. 16.09.2009, nga A B, G H dhe Sh P , në të cilën gjendet edhe paditësit H B me nr. rendor 174 , sipas të cilit paditësi i lindur më dt.ka qenë në punë më dt.19.07.1985, deri më dt. 13.04.2007, dhe ka përvojë pune 21.08 vjet .

Sipas Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN 032- 0061 , dt. 31.05.2013 , është refuzuar kërkesa H B, në shumën 9,00.00€,

Nga përmbajtje e arsytimit të Vendimit të AL theksohet nga të dhënat e siguruar më dt. 23.05.2013, të Bankës Ekonomike rezulton se parashtruesi i kërkesë nuk ishte në listë të pagës së NSH. Bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, ka vlerësuar se në mungesë të dokumentacionit e ka refuzuar kërkesën.

Gjykata vlerëson se AL , i ka të gjitha të dhënat dhe dokumentet nga arkivi i punëtorëve, në NSH, dhe në bazë të tyre ka pasur mundësin të vendos dhe se Banka Ekonomike nuk është adresa e AL për të siguruar prova . E paditura me parashtrës të mbrojtjes nuk është deklaruar fare në provat të cilat i ka pasur në disponim si Lista e pagave për periudhën janar 2006 deri në qershor të vitit 2007.

Gjykata duke marre për bazë nenin 31.5, të Ligjit nr. 06/L-086, në lidhje me pohimin e faktit se paditësi gjendet në listën e punëtorëve që nuk ju janë paguar pagat e pretenduara, bazuar në provat e dorëzuara si lista e pagave, për periudhën janar të vitit 2006 deri në qershor të vitit 2007, vërtetoi faktin se paditësi ishte në listën e pagave, por për periudhën janar gusht të vitit 2006, të njëjtit nuk ju janë llogaritur pagat, kështu që një pohim i paditësit nuk është plotësim i qëndrueshëm dhe se për këtë periudhë kohore nuk është deklaruar për çfarë arsye nuk ju janë llogaritur pagat, ndërsa as paditësi dhe as e paditura nuk janë deklaruar për listën e pagave për muajin maj dhe qershor të vitit 2007 në të cilën listë janë llogaritur pagat vetëm për H B, Sh K dhe Sh Sh pagat e të cilëve ishin të njëjta

E paditura nuk ka dorëzuar asnjë provë me të cilën do të kundërshtonte besueshmërinë e dokumentit të listës së pagave të pa paguara si më lartë, sipas nenit, 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086, kështu që dokumentin listë të pagave e pranoi si provë të besueshme .

Gjykata vlerëson, Autoriteti i Likuidimit me rastin e marrjes së vendimit PRN 032- 0061, me të cilën ka refuzuar kërkesën e paditësit, arsyet e cekuar ishin kundërthënëse me provat që i ka pasur në dispozitim, dhe si pasojë e kësaj nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike sikundër ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, duke zbatuar dispozitën e nenit 36.2.2 të Ligjit nr. 04/L-034 .

Gjykata bazuar në provat të cilat i ka dorëzuar paditësi, si njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, librezën e punës, listën e pagave të pa paguara për periudhën kontestuese dhe në deklarinimin nën betim të ish personave përgjegjës dhe me kompetencë të NSH të dhënë para noterit B Z. Xh, ka vërtetuar një gjendje faktike tjetër, sipas të cilës paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te i padituri deri në momentin e pushimit të marrëdhënies së punës për shkak të privatizimit të NSH Magjistratja dhe se edhe për periudhën shtator të vitit 2006 deri në qershor të vitit 2007, paditësit nuk ju janë paguar pagat e kërkuara në shumën e përgjithshme 900.00€.

Gjykata pasi vërtetoi një gjendje tjetër faktike, vendosi ta ndryshoi Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN 032- 0061, dt. 31.05.2013, dhe ta pranoi kërkesën e paditësit për pagimin e pagave në shumën 900.00€, për 10 paga mujore nga 90.00€.

Me rastin e pranimit të kërkesës së paditësit për pagimin e pagave, gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, me të cilën është parapara „kërkesat e pasiguruara , kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë ” .

Me rastin e caktimit të kamatës 10 % të vlerës së shumës themelore, gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 37, par 3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 me të cilën është parapara „ Të gjitha kërkesat ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit , me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10 % , të shumës themelore ” .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.1, lidhur me nenin 64 të Ligjit për Dhomën e Posaçme , e paditura detyrohet që paditësit t’ ia, paguaj shpenzimet e procedurës në shumën 124.00€, dhe atë për hartim të padis nga avokati 104.00€, dhe për taks gjyqësore 20.00 €.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva

Gjyqtar